



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4412 / Prot.

Datë 14 .09. 2023

VENDIM

NR. 72 DATË 13 . 09. 2023

MBI

“Financim i shpenzimeve të udhëtimit për pjesmarrje në Olimpiadën Ndërkombëtare të Matematikës”,

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____ .09.2023, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi “Financim i shpenzimeve të udhëtimit për pjesmarrje në Olimpiadën Ndërkombëtare të Matematikës”, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimin plotësues nr.2, datë 09.01.2023 të Ministrisë së Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023” dhe vendimin e Këshillit Bashkiak nr.190, datë 27.12.2022, për “Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Elbasan dhe Këshillit Bashkiak për vitin 2023, si dhe miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”,

VENDOSI

1. Miratimin e fondit 177,135 lekë, në Qendrën Ekonomike të Arsimit, për financimin e shpenzimeve të udhëtimit të nxënësit Alden Morja, shkolla e mesme e bashkuar “Luigj Gurakuqi”, i cili mori pjesë në Olimpiadën Ndërkombëtare të Matematikës në Chiba, Japoni, në muajin korrik 2023.
2. Përdorimin e fondit rezervë, në buxhetin e vitit 2023, për shumën 177,135 lekë, për financimin e pikës 1, të këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Buxhetit në Dr.Buxhet Financë dhe Qendra Ekonomike e Arsimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

SEKRETAR
Elvi Çuni

KRYETARI
Lutfi Lala

P/Sekt..Buxhetit : M.Beluli
Dr.Buxhet Finance : A.Merkja
D.P.P.A.B.F: Q.Tusha
Dr.Juridike: A. Hoxha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 1224/1 Prot

Elbasan, më 18.9.2023

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.72, datë 13.09.2023 "*Financim i shpenzimeve të udhëtimit për pjesmarrje në Olimpiadën Ndërkombëtare të Matematikës*", konfirmoj në parim mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI

Majlinda PERRIU



4

1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4200/11 Prot.

Elbasan më 4/09.2023

VENDIM

Nr. 73 Datë 13/09 2023

“Për miratimin e ngritjes, përbërjes dhe funksionimit të Komisionit të Strehimit”

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, në ligjin nr.22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar, VKM nr.384 datë 12.6.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës __.__.2023, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Aseteve dhe Strehimit,

VENDOSI:

1) Miratimin e ngritjes së Komisionit të Strehimit, me përbërje si mëposhtë:

- Kryetar Zv/kryetari i Bashkisë;
- Anëtar Përfaqësues i Drejtorisë së Aseteve dhe Strehimit;
- Anëtar Përfaqësues i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës;
- Anëtar Përfaqësues i Drejtorisë Juridike;
- Anëtar Përfaqësues i Drejtorisë së Shërbimit, Kujdesit Social dhe Komunitar;
- Anëtar Përfaqësues i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit;
- Anëtar Përfaqësues i Drejtorisë së Informacionit Statistikave dhe Koordinimit

2) Pjesëmarrjen, si dëgjues në takimet e këtij komisioni, të përfaqësuesve të organizatave jofitimprurëse me aktivitet në juridiksionin e Bashkisë Elbasan, si mëposhtë:

- Përfaqësues të shoqatave të jetimëve;
- Përfaqësues të shoqatave në mbrojtje të grave;
- Përfaqësues të shoqatave në mbrojtje të PAN;
- Përfaqësues të të persekutuarve politikë;
- Përfaqësues të komunitetit, shoqatave në mbrojtje të të drejtave të minoriteteve rome dhe egjiptiane;
- Përfaqësues të shoqatave në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve;

3) Ky komision strehimi të funksionojë sipas kuadrit ligjor që rregullon fushën e strehimit social.

- 4) Projekt Vendimi Nr. 95 datë 02.08.2022 shfuqizohet.
- 5) Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Komisioni i Strehimit.
- 6) Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI

Lutfi Lala



SEKRETARI

Elvi Çuni



Konceptoi:

A. Beqiri

E. Ibërshimi

Drejtoria A.S:

A. Suli

A. Merkja

Drejtoria F.B:

A. Hoxha

Drejtoria Juridike:

Q. Tusha

Drejtoria P.P.A.A.B.F:

A. Bylykbashi

Zv/kryetar:

A. Bylykbashi

4200/2
20.09.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1025/ Prot.

Elbasan më 20.9.2023

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.73 datë 13.09.2023 "Për miratimin e ngritjes, përbërjes dhe funksionimit të Komisionit të Strehimit" konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4204 prot.

Elbasan, më: 14.09.2023

VENDIM

Nr. 74 Datë 13.09.2023

“Mbi miratimin e formulës së pikëzimit për aplikantët në programet e strehimit social”.

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar, VKM nr. 384 datë 12.6.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, Urdhërin Administrativ Nr.1416 datë 18.08.2023 “Për ngritjen e Komisionit të Strehimit Social”, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____ .09.2023, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan,

KESHILLI BASHKIAK
V E N D O S I

1. Miratimin e Formulës së Pikëzimit për aplikantët në programet e strehimit social.

	KRITERET E PIKËZIMIT	Pikët
1.1	KUSHTET E STREHIMIT	25
1	Banesë që priset/përjashtohet nga legalizimi	5
2	I pastrehë nga proçese gjyqësore	4
3	I pastrehë si rezultat i fatkeqësive natyrore	5
4	Banesë në rrezik shembje	3
5	Nuk disponon banesë në pronësi	5
6	Banojnë në banesa të mbipopulluara	3

1.2	KUSHTET FAMILJARE	25
1	Familje me më shumë se 4 fëmijë	5
2	Të rinjt që kanë një moshë jo më të madhe se 40 vjec	5
3	Familje njëprindërore që ka në ngarkim fëmijë	7
4	I/E moshuar që kam mbushur moshën e pensionit dhe nuk jam përzgjedhur për t'u strehuar në një institucion publik të përkujdesjes shoqërore	3
5	Familje të reja	5
1.3	KUSHTET SOCIALE	25
1	Ka statusin e jetimit dhe moshë deri në 30 vjeç	3
2	Personat me aftësi të kufizuara	2
3	Ka mbetur i pastrehë për shkak të liritimit të banesës ish-pronarëve	2
4	Emigrant i rikthyer / punëtor emigrant	3
5	Familje e punonjësit të Policisë së Shtetit të rënë në detyrë	3
6	Vajzat nëna	1
7	Punonjës i RENEA-s	1
8	Punonjësit e reparteve të ndërhyrjes së shpejtë (FNSH)	1
9	Punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri shpëtimin	2
10	Viktimë e trafikimit	2
11	Anëtar i minoritetit egjiptian	2
12	Anëtar i minoritetit rom	1
13	I mitur në konflikt me ligjin	1
14	Komuniteti LGBTI	1
1.4	KUSHTET EKONOMIKE	25
1	Familje me të ardhura mesatare	4
2	Familje me të ardhura shumë të ulëta	7
3	Familje pa të ardhura	6
4	Familje me të ardhura të ulëta	8

Ndryshimet e bëra në ligjin Nr.48/2023 kanë përcaktuar dhe grupimin e kushteve të përzgjedhjes së aplikantëve.

Në varësi të programit social të strehimit komisioni do të vlerësojë mbi bazën e kriterëve dhe kategorive të programit përkatës.

Numri total i pikëve është 100 pikë.

2. Vendimi Nr.91 datë 02.08.2022 shfuqizohet.

3. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata e Bashkisë dhe Komisioni i Strehimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI

Lutfi Lala



SEKRETARI

Elvi Çuni

KOMISIONI:

Zv/Kryetar i Bashkisë:

Specialiste D. A.S:

Përgj. Dr. Strehimit:

Drejtor D. F.B:

Drejtor D. Juridike:

Drejtor D. P.P.S.S.SH.K.T.I.M:

Specialist D. P.ZH.T:

Përgj. Dr. Koordinimit:

Përgj. Dr. Informacionit:

A. Guni

A. Beqiri

E. Ibërshimi

A. Merkja

A. Hoxha

E. Muço

S. Radonliqi

I. Kaçuli

E. Shota

4201/2
20.09.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

4

Nr. 1020/1 Prot.

Elbasan më 19.9.2023

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.74 datë 13.09.2023 "Mbi miratimin e formulës së pikëzimit për aplikantët në programet e strehimit social" konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.





1027
14.09.2023
6



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4209/1 Prot.

Elbasan, më: 14.09.2023.

V E N D I M

Nr. 75 Datë: 13.09.2023.

"Marrje me qira (rinovim kontrate) ambjent (strehëz emergjence) për Forumin e Gruas Elbasan".

Bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjin nr. 7850 datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës për marrdhëniet familjare", i ndryshuar, V.K.M nr. 327 datë 02.06.2021 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjës për referimin e rasteve të dhunës në marrdhëniet familjare si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës", Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës _____.____.2023, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Strategjike, Sociale, Shërbimeve Komunitare, Teknologjise se informacionit dhe Medias i relaton Këshillit Bashkiak, "Marrje me qira (rinovim kontrate) ambjent (strehëz emergjence) për Forumin e Gruas Elbasan";

V E N D O S I:

1. Miratimin marrje me qira ambjentin me sipërfaqe 98,5 m², ndodhur në Z.K. 8525, Lagja "5 Maj", për periudhën 1 (një) vjeçare nga 15.09.2023 deri 14.09.2024, me vlerë qiramarrje prej 23000 lekë/muaj, për t'a përdorur (strehëz emergjence) për Forumin e Gruas Elbasan.
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Strategjike, Sociale, Shërbimeve Komunitare, Teknologjise se informacionit dhe Medias.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI

Lutfi Lala

SEKRETARI

Elvi Çuni



4202/2
20.09.2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1027/Prot.

Elbasan më 20.9. 2023

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.75 datë 13.09.2023 "Marrje me qira (rinovim kontrate) ambient (strehëz emergjence) për Forumin e Gruas Elbasan" konfirmojnë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI
Majlinda Perriu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4203/11 Prot.

Elbasan, më 14.09.2023

V E N D I M

Nr. 76 Datë: 13.09.2023

"Mbi dhënie në përdorim, (pa kundërshtim) të një ambjenti (klasë) të shkollës së mesme të përgjithshme "Dhaskal Todri", Qendrës Protik".

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; ligji Nr. 7850 datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; V.K.M Nr. 416 datë 11.07.2007 "Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të Paluajtshme Publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Elbasan, të qarkut të Elbasanit", Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës _____.2023 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës dhe Drejtoria e Përgjithshme Operacionale i relaton Këshillit Bashkiak, "Mbi dhënie në përdorim, (pa kundërshtim) të një ambjenti (klasë) të shkollës së mesme të përgjithshme "Dhaskal Todri", Qendrës Protik";

V E N D O S I :

1. Miratimin mbi dhënien në përdorim (pa kundërshtim) të një ambjenti (klasë) të shkollës së mesme të përgjithshme "Dhaskal Todri", me sipërfaqe kati përdhe, 33 m², ndodhur në Lagjen "Dyli Haxhire", Z.K 8523, për t'u përdorur për organizimin e kurseve profesionale nga Qendra Protik, për një periudhë 1 (një) vjeçare (planvendosje bashkëlidhur).
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës dhe Drejtoria e Përgjithshme Operacionale.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI

Lutfi Lala


SEKRETARI

Elvi Çuni



PLANVENDOSJA SHKOLLES "DHASKAL TODRI" LAGJA "DYLI HAXHIRE" NJA NR.3, ZK 8523 INDEKSI HARTES EL: M-8

PLANIMETRIA KATIT PERDHE



Klasa e percaktuar per zhvillimin e klasave te Akademise se
Programimit te Qendres Protik me sip.33 m²

4203/2
20-09-2023



3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1028/ Prot.

Elbasan më 20 9 2023

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.76 datë 13.09.2023 "Mbi dhënien në përdorim, (pa kundërshtim) të një ambienti (klasë) të shkollës së mesme të përgjithshme "Dhaskal Todri", Qendrës Protik" konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4221/ Prot.

Datë 14.09.2023

VENDIM

NR. 77 DATË 13.09.2023

MBI

“Detajim i shtesës së fondeve (grant) dhe transferim fonde nga të ardhurat, për vitin 2023”.

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____ .09.2023, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi “Detajim i shtesës së fondeve (grant) dhe transferim fonde nga të ardhurat, për vitin 2023”, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, shkresën nr.12674, datë 10.07.2023 të Ministrisë së Financave, “Udhëzimin plotësues nr.2, datë 09.01.2023 të Ministrisë së Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023” dhe vendimin e Këshillit Bashkiak nr.190, datë 27.12.2022, për “Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Elbasan dhe Këshillit Bashkiak për vitin 2023, si dhe miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”,

VENDOSI

1. Detajimin e shtesës së fondeve (transfertë e pakushtezuar, grant), për financimin e rritjes së nivelit të pagave për administratën, në zbatim të VKM-së nr.328, datë 31.05.2023, si më poshtë :

Programi		Njësia shpenzuese	Shtesë fondi /lekë	kapitulli	artikulli
01110	Administrata	Bashkia	11,700,000	1	600
01110	Administrata	Bashkia	1,900,000	1	601
03140	Policia Bashkiake	Bashkia	4,500,000	1	600
03140	Policia Bashkiake	Bashkia	755,776	1	601
04260	Sherbimi Pyjor	Bashkia	2,600,000	1	600
04260	Sherbimi Pyjor	Bashkia	400,000	1	601
09230	Personeli konvik.	Q.Ek.Arsimit	400,000	1	600
09230	Personeli konvik.	Q.Ek.Arsimit	90,000	1	601
10430	Çerdhe	Q.Ek.Arsimit	2,150,000	1	600
10430	Çerdhe	Q.Ek.Arsimit	400,000	1	601
08220	Qendra e Artit	Qendra e Artit	2,400,000	1	600
08220	Qendra e Artit	Qendra e Artit	660,000	1	601
08220	T.Kult.+Biblioteke	Tr.Kulturore	500,000	1	600

08220	T.Kult.+Biblioteke	Tr.Kulturore	100,000	1	601
04220	Sherb.bujq.+ veterin.	ASHP	1,000,000	1	600
04220	Sherb.bujq.+ veterin.	ASHP	170,000	1	601
04520	Miremb.rruge	ASHP	2,400,000	1	600
04520	Miremb.rruge	ASHP	450,000	1	601
04570	Transporti	ASHP	300,000	1	600
04570	Transporti	ASHP	100,000	1	601
05100	Sekt.Pastrimit	ASHP	300,000	1	600
05100	Sekt.Pastrimit	ASHP	50,000	1	601
06260	Nd.rrugor	ASHP	200,000	1	600
06260	Nd.rrugor	ASHP	100,000	1	601
10430	Shtepia e te Moshuarve	Q.Soc."Balashe"	500,000	1	600
10430	Shtepia e te Moshuarve	Q.Soc."Balashe"	100,000	1	601
Gjithsej :			34,225,776		

2. Transferimin e fondeve nga të ardhurat për financimin e rritjes së nivelit të pagave për administratën, në zbatim të VKM-së nr.328, datë 31.05.2023, si më poshtë :

Paksohet :

15,227,905 lekë "Rivitalizim urban i rotondës së kryqëzimit tek lulet, "rotondës 1 Maji",
"rotondës Postës" dhe rotondës te Bashkia, programi 04520, artikulli 231,
njësia shpenzuese Bashkia.

276,995 lekë supervizim " "

46,100 lekë kolaudim " "

15,551,000 lekë gjithsej

Shtohet :

Programi		Njësia shpenzuese	Shtesë fondi /lekë	kapitulli	artikulli
01110	Administrata	Bashkia	10,295,000	5	600
01110	Administrata	Bashkia	1,720,000	5	601
01110	Këshilltarë	Bashkia	600,000	5	602
01110	Kryetarë fshatrash	Bashkia	1,378,000	5	602
01110	Ndërlidhësa (komunitarë)	Bashkia	150,000	5	602
04260	Sherbimi pyjor	Bashkia	655,000	5	600
04260	Sherbimi pyjor	Bashkia	110,000	5	601
05100	Ins Mjedisit	Bashkia	551,000	5	600
05100	Insp Mjedisit	Bashkia	92,000	5	601
Gjithsej			15,551,000		

3. Transferimin e fondeve nga të ardhurat për financimin e rritjes së nivelit të pagave për punonjësit mbështetës, në zbatim të VKM-së nr.242, datë 20.04.2023, si dhe financimin e disa shpenzimeve të tjera, më poshtë :

Paksohet :

10,000,000 lekë, fondi kontigjencës, njësia shpenzuese Bashkia;

14,317,447 lekë, "Restaurim i plotë i objektit 2 kat + bodrum, në muze të Postës Shqiptare, ish shtëpisë së Lef Nosit (në bashkëfinancim me Postën Shqiptare), programi 08220, artikulli 231, njësia shpenzuese Trashëgimia Kulturore.

100,000 lekë, "Rivitalizim urban i rotondës së kryqëzimit tek lulet, rotondës (1 Maji, rotondës "Postës" dhe Rotondës te Bashkia, programi 04520, artikulli 231, njësia shpenzuese Bashkia.

24,417,447 lekë gjithsej

Shtohet :

Programi		Njësia shpenzuese	Shtesë fondi /lekë	kapitulli	artikulli
07220	DDD	Q.Ek.Arsimit	1,100,000	5	600
07220	DDD	Q.Ek.Arsimit	200,000	5	601
04240	Ujitja dhe Kullimi	ASHP	3,400,000	5	600
04240	Ujitja dhe Kullimi	ASHP	450,000	5	601
04520	Miremb.rruge rurale	ASHP	7,400,000	5	600
04520	Miremb.rruge rurale	ASHP	600,000	5	601
06260	Sekt.Gjelberimit	ASHP	7,500,000	5	600
06260	Sekt. Gjelberimit	ASHP	1,500,000	5	601
06260	Miremb.Varreza	ASHP	700,000	5	600
06260	Miremb.Varreza	ASHP	100,000	5	601
04130	Tregu Lire	ASHP	300,000	5	600
04130	Tregu Lire	ASHP	60,000	5	601
03280	Emergjencia Civile (Supervizim + kolaudim) "Ndërtimi i rrjetit të hidranteve për Krastën"	Bashkia	307,447	5	231
08130	Aktivitetet (110 vjetori)	Sport Klubi	700,000	5	602
08220	"Blerje tapet"	Qendra Artit	100,000	5	231
		Gjithsej :	24,417,447		

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Buxhetit në Dr.Buxhet Financë, Drejtoria e Prokurimeve, Drejtoria e Emergjencave Civile dhe njësitë vartëse të Bashkisë.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

SEKRETAR
Elvi Çuni

KRYETARI
Lutfi Lala

4281/2
20.09.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 1029 Prot

Elbasan, më 18.9.2023

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.77, datë 13.09.2023 "Detajim i shtesës së fondeve (grant) dhe transferim fonde nga të ardhurat, për vitin 2023", konfirmoj në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI
Majlinda PERRIU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4220/1 Prot.

Datë 14.09.2023

VENDIM

NR. 78 DATË 13.09.2023

“Miratimin e fondeve për “Projekte me Bashkëfinancim” për vitin 2023 ,2024”

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ . 2023, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi **“Mbi Miratimin e fondeve për “Projekte me Bashkëfinancim” për vitin 2023, 2024”**, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, udhëzimin nr.2, datë 19.01.2023 të Ministrisë së Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023” dhe vendimin e Këshillit Bashkiak nr.190, datë 27.12.2022 mbi “Miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2023”, i ndryshuar,

VENDOSI :

1. Të miratojë transferimin e fondeve në buxhetin e vitit 2023 (nga të ardhurat dhe granti), për Bashkinë dhe njesitë vartëse të saj, si më poshtë:

Paksohet :

-7,000,000 lekë	artikulli 231 “Programi 06140, Njësia Shpenzuese Bashkia,nga të ardhurat “Rikonstruksion në Banesa (Bashkëfinancim në projekte)
-178,511 lekë	artikulli 231 “Program 04520, Njësia Shpenzuese Bashkia, nga të ardhurat “Rivitalizim urban i rotondës së kryqëzimit tek luleve, rotondës “1 Maji”, rotondës “Postës” dhe Rotondës tek” Bashkia”
-560,000 lekë	artikulli 231 Programi 01110, Njësia shpenzuese Bashkia Elbasan, nga të ardhurat “Blerje skaner profesional, Aparat fotografik profesional + lente, laptop, projektor”
-90,000 lekë	artikulli 231 Programi 01110, Njësia Shpenzuese Bashkia ,nga të ardhurat “Ndërtim i faqes së internetit për Këshillin Bashkiak, ,



-7,100 lekë	artikulli 231 Programi 01110, Njësia Shpenzuese Bashkia ,nga të ardhurat “Blerje tablete për sistemin e Kadastrës Fiskale”
-350,000 lekë	artikulli 231 Programi 08220, Njësia Shpenzuese Trashëgimia Kulturore nga Grandi “Botim i materialeve të Aleks Vinit”
-6,057 lekë	“Restaurim i plotë i objektit 2 kat + bodrum, në muze të Postës Shqiptare, i ish shtëpisë së Lef Nosit” (në bashkëfinancim me Postën Shqiptare), programi 08220, artikulli 231, njësia shpenzuese Trashëgimia Kulturore, nga të ardhurat
-588,257 lekë	artikulli 231 Programi 08220, Njësia Shpenzuese Trashëgimia Kulturore, nga të ardhurat Supervizim “ ”.
-88,239 lekë	artikulli 231 Programi 08220, Njësia Shpenzuese Trashëgimia Kulturore, nga të ardhurat Kolaudim “ ”.
-966,908 lekë	artikulli 231 Programi 06370, Njësia Shpenzuese Agjencia e Shërbimeve Publike, nga grandit “Ndërtim puse parku, varrezat”
9,835,072 lekë gjithsej.	

Shtohet :

-7,000,000 lekë	artikulli 231 Programi 04520 Njësia Shpenzuese Bashkia “Përmirësim i infrastrukturës kryesisht në zona informale (Rikonstruksion i Gjendjes ekzistuese të rrugës Arif Dardha)” (Bashkëfinancim, vlera totale =17,821,180, financiar ne 2 vite, viti 2023= 7,000,000 leke, viti 2024 = 10,821,180 lekë)
-651,608 lekë	artikulli 231 program 04520 Njësia Shpenzuese Bashkia “Supervizim I Objektit “ ”
-78,193 lekë	artikulli 231 program 04520 Njësia Shpenzuese Bashkia “Kolaudim I Objektit “ ”
-2,105,271 lekë	artikulli 231 Program 01110 Njësia Shpenzuese Bashkia “Furnizim-Vendosje paneleve diellore në ndërtesën e rikonstruktuar të Bashkisë Elbasan (Bashkëfinancim me GIZ), (nga ku 1,316,908 Grant dhe 788,363 të ardhurat)

9,835,072 lekë gjithsej.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhet Finances (Sektori i Buxhetit), Drejtoria e Prokurimeve, Agjensia e Shërbimeve Publike dhe Qendra e Trashegimise Kulturore”.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.



SEKRETAR
Elvi Çuni



KRYETAR
Lutfi Lala



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 1030/1 Prot

Elbasan, më 18.9.2023

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.78, datë 13.09.2023 "Miratimin e fondeve për "Projekte me Bashkëfinancim" për vitin 2023, 2024", konfirmoj në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI
Majlinda PERRIU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al

VENDIM

Nr. 79 Datë 13.09.2023

Për ndryshimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak Elbasan nr. 58 datë 26.05.2023

"Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile për vitin 2023"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; nenit 65 të ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile", VKM nr. 414 datë 8.7.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve për përdorimin dhe shpërndarjen e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile"; si edhe pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile;

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I

1. Miratimin e ndryshimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 58 datë 26.05.2023 dhe rialokimin e një pjese të fondit të Mbrojtjes Civile prej **17,222,570** lekë në mënyrën e mëposhtme.

Nr.	Emërtimi i objektit	Shuma	Vlera e shtuar	Bëhet
1.	Riparim i Argjinatures mbrojtese te Perroit Zaranike (përfshirë supervizim + kolaudim)	5,161,000	2,564,828	7,725,828
2.	Mbrojtja e lagjes Nonëve nga gërryerja e Perroit të Gostimës fshati Polis Valë, Njësia Administrative Shushicë (përfshirë supervizim + kolaudim)	6,500,509	X	0
3.	Ndertim i ures që lidh rrugën "Papri" me rrugën "Xhikzonjës" në përroin Gostimë	5,561,523	3,935,219	9,496,742



(faza e 2) në fshatin Bujaras, Njësia Administrative Gjergjan (përfshirë supervizim + kolaudim)			
Totali	17,222,570	6,500,509	17,222,570

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Emergjencave Civile).
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

KRYETARI

Lutfi Lala

Konceptoi:

Specialist

I. Hoxholli

Pranoi:

Përgj. Sektori

Xh. Kapllanaj

Miratoi:

Drejtori EC

N. Sinani

Konfirmoi:

Drejtori PSHI

S. Mehmeti

Zv/ Kryetari

A. Bylykbashi



4206/2
20.08.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 1039/1 Prot

Elbasan, më 18.9.2023

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.79, datë 13.09.2023 Për ndryshimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak Elbasan nr.58 datë 26.05.2023 "Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile për vitin 2023", konfirmoj në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI
Majlinda PERRIU



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË ELBASAN**

Nr. 1386 Prot

Elbasan, më 19.09.2023

VENDIM

Nr. 80 datë 13.09.2023

PËR

"Miratimin e tabelës së pagave me ndryshime në reflektim të Vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave, si dhe të tabelës së shpërndarjes së punonjësve në Bashki dhe Institucione vartëse"

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 8, pika 2, neni 9, pika 1.1, gërma "ç", neni 26, neni 27, neni 33, neni 54, gërma "d" dhe "dh", Ligjit Nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", neni 3, pika 8, si dhe të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", me qëllim për të rritur performancën e ushtrimit të funksioneve vendore të mbrojtjes së mjedisit, pyjeve, natyrës dhe bisodiversitetit të bashkisë Elbasan, bazuar në relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Administratës, Burimeve Njerëzore dhe Monitorimit të Performancës të Bashkisë Elbasan, në mbledhjen e tij të datës 13.09.2023, pasi mori në shqyrtim propozimin e zv.Kryetarëve të Bashkisë Elbasan, Këshilli i Bashkisë Elbasan

VENDOSI:

1. Të miratojë nivelin e pagave të punonjësve të Bashkisë Elbasan dhe Njësive të saj vartëse, sipas lidhjeve 1 – 12 bashkëlidhur relacionit.

1. Të miratojë shpërndarjen e numrit të punonjësve në Bashki dhe Institucione Vartëse, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtoria e Administratës, Burimeve Njerëzore dhe Monitorimit të Performancës, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Institucionet e Vartësisë së Bashkisë Elbasan.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Elvi ÇUNI

KRYETAR

Lutfi LALA

Konc: Ermira Tafani (Drejtore e DABNJMP)

Alketa Merkja (Drejtore e DBF)

Arben Hoxha (Drejtore e Drejtorisë Juridike)

Miratoi: Agron Lulaj (Drejtore e Përgjithshme)

Qemal Tusha (Drejtore e Përgjithshme)

Konfirmoi:

Aulona Bylykbashi (zv. Kryetar e Bashkisë)

Vesa Liço (zv. Kryetar e Bashkisë)



**Tabelë e shpërndarjes së numrit të punonjësve në Bashki dhe Institucione
Vartëse**

Nr.	Institucioni	Nr. i punonjësve
1.	Administrata e Bashkisë (përfshirë funksionet e deleguara), Njësive Administrative dhe Lagjeve	498
2.	Shërbimi Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi	35
3.	Qendra Ekonomike e Arsimit	99
4.	Klubi Shumësportësh	46
5.	Qendra e Artit	34
6.	Agjencia e Kulturës dhe Turizmit	41
7.	Qendra Sociale Balashe	48
8.	Njësia e Menaxhimit të Banesave Sociale	4
9.	Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale + Agjencia e Shërbimeve Publike Urbane	172
10.	Agjencia e Pyjeve dhe Mjedisit	49
11.	Arkiva shtetërore	10
12.	Arsimi	428
	Nr. i përgjithshëm	1464



Niveli i pagave për Funkionarët, Nëpunësit Civilë dhe Punonjësit e Bashkisë Elbasan					
NR.	Pozicioni	Kategoria / Klasa	Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi në %	Paga për pozicion
I	Punonjës të sistemit me kategori e pagë grupi + shtesë pozicioni				
1	Kryetari i Bashkisë				185000
2	Zv/Kryetar i Bashkisë				160000
3	Sekretar i Përgjithshëm	I B	1	2%	121000
4	Drejtor i Përgjithshëm / Koordinator i Zhvillimit Urban	II A	1	2%	107000
5	Sekretar i Këshillit Bashkiak / Shef Kabineti / Drejtor Drejtorie	II B	1	2%	91000
6	Përgjegjës i Protokollit Zyrtar / Kryeinspektor i Inspektoriatit të Kontrollit dhe Mbrojtjes së Territorit	II B	1	2%	88000
7	Përgjegjës Sektori Arkiv Protokoll / Menaxhimi i Burimeve Njerëzore / Monitorimi i Performancës / Buxhet / Financë-Kontabilitet / Këshillimi i Biznesit / Vlerësimi i Kadastrës Fiskale / Borxhi / Terreni / Njësi e Prokurimit / Kontrolli i Lejeve / Kushtet ligjoro-teknike të territorit / Planifikimi dhe zbatimi i infrastrukturës në territor	III A		2%	78000
8	Këshilltar / Përgjegjës Menaxherial / Përgjegjës sektori	III A / 1		2%	73900
9	Specialist Audit / Protokoll / Arkiv / Arkivë teknike / Aanalist pune / Administrim dokumentacioni / Rakordimi i të ardhurave / Sekretariati i Këshillit Bashkiak / Drejtoria Buxhet Financë / Prokurime / Planifikim e Zhvillim Territori / Projektimi topografik	III B	1 ose 2	2%	65000
10	Specialist / Inspektor / Supervizor / Arkëtar / Përpunues të dhënash / Zëdhënës Shtypi / Arshivist i Medias	III B	1 ose 2	2%	60000
11	Specialist Drejtoria Buxhet Financë / Planifikim e Zhvillim Territori / Projektimi topografik / Kujdesi Social / Sektori Arkiv - Protokoll / IT / Sekretariati i Këshillit Bashkiak	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	56000
12	Specialist / Inspektor / Supervizor / Agjent / Zëdhënës Shtypi / Arshivist i Medias / Punonjës jashtë shërbimit civil	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	51000
13	Sekretar / Arkëtar / Magazinier	IV B	1 ose 2 ose 3	2%	44000
II	Punonjës të sistemit me klasa	Klasa		Shtesa për vjetërsi në %	Paga bazë
1	Llogaritar / Ekonomist i mesëm / Arkëtar / Topograf	VIII		1%	44100
2	Roje mjedisore me arsim të mesëm	VII		1%	43600
3	Operator parkimi / Operator tatimor / magazinier	IV		1%	42500
4	Shofer / Punonjës mirmbajtjeje	III		1%	41800
5	Punonjës Shërbimi / Punëtor	I		1%	40000

1. Pagat e punonjësve sipas kategorive do të jenë në mbështetje të VKM nr.328 datë 31.5.2023.

2. Shtesa për vjetërsi në punë, të jepet në masën 2% për qind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi shtesën e nivelit të kualifikimit.

3. Pagat e punonjësve sipas klasave do të jenë në mbështetje të VKM nr.326 datë 31.5.2023, pika 1 germa "b".

4. Shtesa për vjetërsi në punë për pagat e nivelit me klasa të llogaritet për çdo vit pune, në masën 1 (një) për qind të pagës bazë për klasë, por jo më shumë se 25 (njëzet e pesë) vjet.

5. Paga për punonjësit e arkivës shtetërore bën pjesë tek pika 12, "punonjës jashtë shërbimit civil"



Lidhja Nr.2

Niveli i pagave për punonjësit e Gjendjes Civile të Bashkisë Elbasan

NR.	Pozicioni	Kategoria/Klasa	Shtesa e nivelit të kualifikimit	Paga për pozicion
1	Përgjegjës i Zyrës së Gjendjes Civile në Bashki si funksion i deleguar	IV/2	1	70000
2	Specialist i Zyrës së Gjendjes Civile në Bashki si funksion të deleguar	IV/3	1 ose 2 ose 3	60000
3	Përgjegjës i Zyrës së Gjendjes Civile ne Komunë si funksion të deleguar	IV/3	1	60000

1. Pagat e punonjësve të Gjendjes Civile në Bashki dhe Njësi Administrative të jetë sipas

VKM Nr.325, datë 31.05.2023.

2. Shtesa për vjetërsi në punë jepet në masën:

- 0.6% pas çdo viti pune për 10 vitet e para (1-10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- 0.8% pas çdo viti pune për 10 vitet e dyta (11-20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- 1% pas çdo viti pune për 10 vitet e treta (21-30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit.




Lidhja 3

Niveli i pagave për Policinë Bashkiake					
Nr.	Emërtimi	Kategoria/Klasa	Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi në %	Paga për pozicion
	Punonjës të sistemit me pagë grupi + shtesë pozicioni				
1	Kryeinspektor	II B	1	2%	84000
2	Inspektor	III A/1	1	2%	63000
3	Jurist / punonjës arkiv protokoll / Punonjës i Policisë Bashkiake	IIIB	1 ose 2	2%	57000
4	Punonjës arkiv protokoll / Punonjës i Policisë Bashkiake	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	55000
5	Polic Bashkiake me arsim të mesëm			1%	47000

1. Pagat e punonjësve sipas kategorive jetë në mbështetje të VKM nr.328 datë 31.05.2023, pika 11.
2. Shtesa për vjetërsi në punë, të jepet në masën 2% për qind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi shtesën e nivelit të kualifikimit.
3. Shtesa për vjetërsi në punë për pikën 5, të jepet në masën 1 (një) për qind të pagës bazë për klasë, por jo më shumë se 25 (njëzet e pesë) vjet.

[Signature]

[Signature]

[Official Seal: REPUBLIKA E SHQIPËS - POLICIA E BASHKISË]

Lidhja Nr.4

Niveli i pagave për Funkionarët dhe Punonjësit e Njësive Administrative dhe Lagjeve

NR.	Pozicioni	Kategoria/K lasa	Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi në %	Paga për pozicion
I	Administratorët e Njësive Administrative				
1	Administrator Njësia Administrative Shirgjan / Gjergjan / Shushicë / Gjinar / Papër / Bradashesh / Labinot- Mal / Labinot- Fushë (5000 - 20000 banorë)				91000
2	Administrator Njësia Administrative Zavalinë / Funar / Tregan / Gracen (më pak se 5 000 banorë)				80000
II	Punonjës të sistemit me kategori e pagë grupi + shtesë pozicioni				
1	Administrator Lagjeje	II B	I	2%	91000
2	Punonjës në Njësi ose lagje / Sekretar / Arkëtar	IV B	1 ose 2 ose 3	2%	44000
III	Punonjës të sistemit me klasa	Klasa		Shtesa për vjetërsi në %	Paga bazë
1	Punonjës i Gjendjes Civile në Njësi Administrative / Punonjës në Njësi / Lagje	X		1%	45300
2	Llogaritar / Ekonomist i mesëm / Arkëtar	VIII		1%	44100
3	Punonjës Shërbimi / Punëtor	I		1%	40000

1. Pagat e punonjësve sipas kategorive do të jenë në mbështetje të VKM nr.328 datë 31.5.2023.

2. Shtesa për vjetërsi në punë, të jepet në masën 2% për qind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet,

dhe llogaritet mbi shtesën e nivelit të kualifikimit.

3. Pagat e punonjësve sipas kategorive do të jenë në mbështetje të VKM nr.326 datë 31.5.2023.

4. Shtesa për vjetërsi në punë për pagat e nivelit me klasa të llogaritet për çdo vit pune, në masën 1 (një) për qind të pagës bazë për klasë, por jo më shumë se 25 (njëzet e pesë) vjet.



[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

Lidhja nr.5

Niveli pagave për punonjësit e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin						
NR.	Pozicioni	Paga bazë për gradë	Shtesa për natyrë të veçantë punë	Shtesa për vjetërsi në %		
I	Punonjës të shërbimit zjarrfikës					
1	Komisar zjarrfikës	97500	6000	1%		
2	Kryeinspektor zjarrfikës	74500	6000	1%		
3	Inspektor zjarrfikës	64200	6000	1%		
4	Kryezjarrfikës	55000	8000	1%		
5	Zjarrfikës	52500	8000	1%		
6	Asistent zjarrfikës	46000	7000	1%		
